

K O N T R A T E

PER THEMELIMIN E SHOQERISE PRIVATE ME ORTAKERI TE RADIOTELEVISIONIT RTV "TEUTA" SHPK

Eshte krijuar nje Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar me emertimin RTV "TEUTA" Shpk Durres ALBANIA,nga ne ORTAKET:

1.Z.GEZIM ALI DOMI,i datlindjes 27.12.1959,me kombesi e shtetesi shqiptar,banues ne DURRES,Tel.Home: 25981.

2.Z.BASHKIM DALIP HOXHA,i datlindjes 02.02.1954,me kombesi e shtetesi shqiptar, banues ne DURRES,Tel.Home: 25342

BAZAT JURIDIKE TE AKTIT TE THEMELIMIT

* KUSHTETUTA e Republikes se Shqiperise.

* Ligji Nr.7632 dt.04.II.1992" Per Dispozitat qe rregullojne pjesen e pare te KODIT TREGETAR".

* Ligji Nr.7638 dt.19.II.1992 " Per Shoqerite TREGETARE"

* Ligji Nr.8410 dt.30.09.1998 " Per RADIOTELEVISIONIN Publik e Privat ne Republiken e Shqiperise"

* Ligji Nr.8288 date 18.02.1998 " Per Entin Rregullues te Telekomunikacionit"

* Ligji Nr.7564 date 19.05.1992" Per te Drejtat e AUTORIT" e ndryshimet plotesuese te tij,te bera me ligjin 7923 dt.19.04.95

* KONVENTAT Nderkombetare te njohura e te gjithepranuara.

Bazuar ne Aktet Konstitucional dhe ligjore te mesiperme,ne Shtetasit shqiptare, biem dakord si me poshte:

NENI 1

Themelojme nje Shoqeri private me Ortakeri,per te zhvilluar veprimtari te perbashket,ne fushen e Radiotelevizionit Lokal,te emertuar : RTV " Teuta" Shpk Durres ALBANIA.

Shoqeria do te kete Seline Qendrore te saj ne kete Adrese:

L. Nr.II,Rruga"A.GOGA" Pallati Kultures"Aleksander Moisiu"DURRES.

Me vendim te Mbledhjes se Ortakeve te Shoqerise,mund te krijohen ose te mbyllen(ne rastin kur jane celur) SELI,FILIALE, Agjensi dhe Perfaqesi ne qytete te tjera te vendit ose jashte tij.

NENI 2

Shoqeria eshte Person Juridik VENDASE ,dhe ushtron nje Aktivitet ZONAL,me qender ne Durres dhe Antene Kryesore ne DAJT me te drejten qe te aktivitetin e saj ta zgjeroj duke e shtrire ne te gjithë vendin si dhe jashte shtetit.

NENI 3

Personalitetin e saj Juridik,Shoqeria e fiton nga data e Rregjistrimit te saj ne Rregjistrin Tregetar TIRANE.

Veprimtarine e fillon pas dhenies se LICENCES , botimit te saj ne Fletoren Zyrtare dhe rregjistrimit ne Organin Tatimor.

NENI 4

Ushtrimi i veprimtarise radiotelevizive ZONALE,do te behet per nje kohezgjatje 3 Vjet per transmetimet radiofonike dhe 5 VJET per transmetime televizive,duke filluar ky afat nga dita e Botimit te vendimit per Dhenien e Licences ne Fletoren Zyrtare,dhe me te drejten e RINOVIMIT te KOHEZGJATJES sipas parashikimeve ne Ligj.

NENI 5

KAPITALI fillestar i Themelimit te Shoqerise,eshte 100.000 (njqindemije) leke te reja,i formuar dhe i nenshkruar ne menyre te barabarte ne masen 50% te tij,nga sejcili Ortak.

Shoqeria mund te shtoj Kapitalin e saj,mbi bazen e vendimitte Asamblese se Ortakeve.

Mbi bazen e Kontributit te Kapitalit do te ndahet edhe fitimi i realizuar gjate veprimtarise se Shoqerise.

PJESE e kontributit aktiv ne Kapital,ne masen 20% do te jene dhe te ardhurat qe sejcili ORTAK realizon nepermjet krijimtarise

se pavarur letrare,artistike,skenariste,teknike dhe te cdo lloj aktiviteti tjetër privat qe ai ne menyre te pavarur e siguron per shkak te cilesive profesionale individuale te tij,dhe ne ato raste kur per kete ai perdor dhe sherbimin dhe siglen e shoqerise

duke mos perjashtuar edhe cdo marrveshje tjetër te vecante midis dy ortakeve.

NENI 6

SHOQERIA,krijohet per te ushtruar AKTIVITET ne keto drejtime:

* Prodhimin,transmetimin dhe ristransmetimin e Programeve dhe informacioneve Radiofonike dhe TELEVIZIVE te cdo lloji,me ane te zerit, sinjaleve te koduara, shkrimit te destinuar per PUBLIKIM, nepermjet valeve elektromagnetke, kablllove, perseriteve, sateliteve dhe cdo mjeti tjetër komunikimi publik.

* Prodhimin dhe transmetimin e filmave televizive dhe 35 mm prodhime dhe riprodhime audiovizive, botim dhe tregetim librash, revistash,gazetash,si dhe ushtrimin e veprimtarise teatrore e te cdo lloj arti tjetër skenik,blerje me qellim shitje me ane te import eksportit te kasetave audiovizive dhe videokamerave, te pjeseve te kembimit per aparaturen dhe tekniken televizive si dhe kryerjen e cdo sherbimi per montimin dhe riparimin e tyre etj.

* Distribuim te prodhimeve audiovizive,filmave,shfaqjeve teatrore, botimeve, videokasetave, berjen e promovimeve te librave te autoreve vendas dhe te huaj,organizim manifestimesh kulturor.

* Te realizoje bashkeprodhime televizive filmike,shkencore e te cdo drejtimi tjetër te lejuar nga Ligji vendas dhe Konventat nderkombetare me PRODUCENTE te ndryshem,vendas ose te huaj si dhe shkembimin,shperndarjen dhe tregetimin me shumice e pakice te cdo prodhimi televiziv, audioviziv, kasetave,filmave, librave, skenarve si dhe transmetimin kinematografik, duke respektuar te drejten e autorit te vetem ose te bashkeautoreve si ne transmetim dhe ne fushen e shperblimit te tyre moral e material.

* Te transmetoje EMISIONE me karakter informativ, edukativ, kulturor, kinematografik, teatror, artistik, argetues, sportiv, reklama etj.

*prodhimin dhe tregtimin e fotografive per publikun e gjere dhe subjekte private, organizimin e ekspozitave fotografike dhe manifestimeve te artit fotografik.

* Shoqeria ka te drejte te marre pjese ne festivale kombetare dhe nderkombetare ne te gjitha fushat qe percaktohen ne objektin e veprimtarise se saj.

* Te jape PROGRAME ne Gjuhe Shqipe, vepra muzikore me tekst ne gjuhe te Huaj dhe EMISIONE per mesimin e Gjuheve te Huaja, filma me version origjinal duke bere dhe shoqerimin e tyre me SUBTRITIM dhe DUBLIMIN ne gjuhen shqipe.

* Te transmetoje program TELEVIZIV jo me pak se 4 ore ne dite ndersa ne RADIO jo me pak se 6 ore,te jap Programe te huaja sipas frekuencave te lejuara,te beje transmetime nga Shqiperia ne

VOTER
DURRES

drejtim te vendeve te tjera(per te trete),sipas Aktmarrveshjeve dy ose shumepaleshe,ne perputhje me Konventat Nderkombetare.

* Te TRANSMETOJ Lajme dhe informacione,te beje sponsorizime duke pranuar financime te drejtperdrejte ose te terthorta nga persona te ndryshem,Fizik ose Juridik,vendas apo te huaj,me qellim reklame etj.

*Veprimtari te vecanta mund te behen edhe nen emra simbolike te ndryshem por gjithmone Bordi miraton emertimin dhe personin pergjegjes te ngarkuar nga Teuta TV.

NENI 7

ORTAKET kane pavaresi ligjore,organizative si dhe te drejta pronesie dhe perfitimi ne rruge trashegimie.

NOTE DURRESE
Shoqeria pergjigjet vetem me KAPITALIN e saj.

NENI 8

ORGANET DREJTUESE te Shoqerise jane:

1.Mbledhja e ASAMBLESE se ORTAKEVE.

2.ADMINISTRATORET.

3.BORDI I ADMINISTRIMIT,si organ Keshillimor.

NENI 9

Ortaket,Z.BASHKIM HOXHA dhe Z.GEZIM DOMI jane njekohesisht dhe ADMINISTRATORET e Shoqerise dhe ushtrojne te gjitha te drejta VENDIMORE,qe Ligji i njej Mbledhjes se Ortakeve te Shoqerise te krijuar nga dy ose me shume persona.....

* Me vendim te Asamblese se Ortakeve,ADMINISTRATOR mund te caktohet dhe nje person i jashtem,jo Ortak i Shoqerise.

* ADMINISTRATORET,qe jane Ortake kane te gjitha kompetencat per te vepruar ne mardheniet me te tretet ne emer te Shoqerise si vecas dhe bashkarisht,ndersa Administratori jashte bashkesise se Ortakeve,i realizon kete te drejta,vetem mbi bazen e Prokures se dhene nga Ortaket.....

NENI 10

BORDI ADMINISTRIMIT,do te perbehet nga 5 Anctare(3 te brendeshem dhe 2 te jashtem),te cilet do te jene eksperte per problemet e administrimit, finances,biznesit dhe te anes juridike dhe qe caktohen me Vendim te Mbledhjes se Asamblese se Ortakeve.


Bordi i Administrimit,eshte vetem organ keshillimor dhe nuk gezon tagrin juridik te nje organi vendimmarres.

ORTAKET THEMELUES TE SHOQERISE

RTV " TEUTA " Shpk

1.Gezim Domi

2.Bashkim Hoxha





TEUTA RTV shpk

STATUT

I SHOQERISE PRIVATE ME ORTAKERI TE RADIOTELEVIZION RTV "TEUTA" SHPK

NENI 1

Eshte krijuar nje Shoqeri me Ortakeri, me pergjegjesi te Kufizuar, me EMERTIMIN. RTV "TEUTA"Shpk DURRES-ALBANIA, ne mes shtetasve shqiptare:

1. **Z. GEZIM ALI DOMI**, i datlindjes 27. 12. 1959, me kombesi e shtetesi shqiptare, banues ne Durres, Tel. Home: 25981.
2. **Z. BASHKIM DALIP HOXHA**, i datelindjes 02. 02. 1954, me kombesi e shtetesi shqiptare, banues ne Durres, Tel. Home: 25342

NENI 2

Shoqeria e zhvillon veprimtarin e saj, duke u bazuar ne Legjislicionin vendas, Konventat Nderkombetare, Aktin e THEMELIMIT dhe STATUT.....

NENI 3

SELIA QENDRORE eshte ne adresen: L. II, Rr. "Aleksander Goga" Pallati i Kultures "Aleksander MOISIU", Durres, Tel/Fax 236 99 ASAMBLEA e Ortakeve ka te drejte te ndryshoje Seline e saj si dhe te krijojte dhe mbylle FILIALE apo PERFAQESI te tjera, si ne Shqiperi dhe jashte shtetit.

VULA e Shoqerise do te kete EMERTIMIN : RTV"TEUTA"Shpk Durres ALBANIA.

NENI 4

Shoqeria eshte PERSON JURIDIK vendas dhe ushtron nje Aktivitet ZONAL(LOKAL) ne nje Juridiksion qe perfshin te gjithe zonen e ulet bregdetare, me te drejten qe te arrije shtrirjen e ketij aktivitetit ne te gjithe vendin si dhe jashte shtetit.

NENI 5

PERSONALITETIN e saj Juridik, Shoqeria e fiton nga data e njohjes Person Juridik me vendim te Gjykates shkalles se pare TIRANE dhe Rregjistrimin e saj ne Rregjistrin Tregetar te kesaj Gjykate.

NENI 6

Ushtrimi i veprimtarse Radiotelevizive LOKALE, do te behet per nje kohezgjatje 3 VJET per tranmetimet RADIOFONIKE dhe 5 VJET per ato TELEVIZIVE, dhe me shume se 10 vjet per veprimtarite e tjera duke filluar ky AFAT nga dita e Botimit te Vendimit per dhenien e Licences ne FLETOREN ZYRTARE, dhe me te drejten e RINOVIMIT TE KOHEZGJATJES, sipas parashikimeve ne LIGJ.



NENI 7

KAPITALI fillestar i THEMELIMIT te Shoqerise, eshte 100.000 Lek (njeqindemije) Lek te reja, i formuar dhe nenshkruar ne menyre te barabarte ne masen 50% te tij, nga seicili ORTAK.

NENI 8

SHOQERIA, krijohet per te ushtruar AKTIVITET ne keto drejtime:

* Prodhimin, transmetimin dhe ristransmetimin e Programeve dhe informacioneve Radiofonike dhe TELEVIZIVE te cdo lloji, me ane te zerit, sinjaleve te koduara, shkrimit te destinuar per PUBLIKIM, nepermjet valeve elektromagnetike, kabllave, perseriteve, sateliteve dhe cdo mjeti tjeter komunikimi publik.

* Prodhimin dhe transmetimin e filmave televizive dhe 35 mm prodhime dhe riprodhime audiovizive, botim dhe tregtim librash, revistash, gazetash, si dhe ushtrimin e veprimtarise teatrore e te cdo lloji tjeter skenik, blerje me qellim shitje me ane te import eksportit te kasetave audiovizive dhe videokamerave, te pjeseve te kembinit per aparatoren dhe tekniken televizive si dhe kryerjen e cdo sherbimi per montimin dhe riparimin e tyre etj.

* Distribuim te prodhimeve audiovizive, filmave, shfaqjeve teatrore, botimeve, vidiokasetave, berjen e promovimeve te librave te autoreve vendas dhe te huaj, organizim manifestimesh kulturore.

* Te realizoj bashkeprodhime televizive filmike, shkencore e te cdo drejtimi tjeter te lejuar nga Ligji vendas dhe Konventat nderkombetare me PRODUCENTE te ndryshem, vendas ose te huaj si dhe shkembimin, shperndarjen dhe tregtimin me shumice e pakice te cdo prodhimi televiziv, audioviziv, kasetave, filmave, librave, skenarve si dhe transmetimin kinematografik, duke respektuar te drejten e autorit te vetem ose te bashkeautoreve si ne transmetim dhe ne fushen e shperblimit te tyre moral e material.

* Te transmetoj EMISIONE me karakter informativ, edukativ, kulturor, kinematografik, teatrore, artistik, argetues, sportiv, reklama etj.

* Prodhimin dhe tregtimin e fotografive per publikum e gjere dhe subjekte private, organizimin e ekspozitave fotografike dhe manifestimeve te artit fotografik.

* Shoqeria ka te drejte te marre pjese ne festivale kombetare dhe nderkombetare ne te gjitha fushat qe percaktohen ne objektin e veprimtarise se saj.

* Te jap PROGRAME ne Gjuhe Shqipe, vepra muzikore me tekst ne gjuhe te huaj dhe EMISIONE per mesimin e Gjuheve te huaja. filma me version origjinal duke bere dhe shoqerimin e tyre me SUBTRITIM dhe DUBLIMIN ne gjuhen shqipe (nje vit pas licensimit).

* Te transmetoj program TELEVIZIV jo me pak se 4 ore ne dite ndersa ne RADIO jo me pak se 6 ore, te jap Programe te huaja sipas frekuencave te lejuara, te beje transmetime nga Shqiperia ne drejtim te vendeve te tjera (per te trete), sipas Aktmarrveshjeve dy ose shumepaleshe, ne perputhje me Konventat Nderkombetare.

* Te TRANSMETOJ Lajme dhe informacione, te beje sponsorizime duke pranuar financime te drejtperdrejte ose te terthorta nga persona te ndryshem, Fizik ose Juridik, vendas apo te huaj, me qellim reklame etj.

* Veprimtari te vecanta mund te behen edhe nen emra simbolike te ndryshem por gjithmone Bordi miraton emertimin dhe personin pergjegjes te ngarkuar nga Teuta RTV.

KREU II:
KUSHTET EKONOMIKE

NENI 9

Shoqëria mund të shtoj ose pakësoj KAPITALIN e saj, mbi bazën e vendimit me shkrim të Asamblesë së Ortakëve.

Mbi bazën e Kontributit të Kapitalit, do të ndahet dhe FITIMI i realizuar gjatë ushtrimit të veprimtarisë së Shoqërisë.

NENI 10

PJESE Kontributi AKTIV në KAPITAL (shtesa me vlerë AKUMULIMI) në masën 20% do të jenë dhe nga vlera e të ardhurave, që secili ORTAK, realizon me anë të krijimtarisë së pavarur letrare, artistike, skenariste, botuese, teknike dhe të çdo lloji aktiviteti tjetër privat, për shkak të cilësive profesionale individuale të tij dhe në rastet kur për këtë gjë ai përdor dhe shërbimin radioteleviziv të Shoqërisë.

NENI 11

KAPITALI nuk mund të jetë në asnjë rast i përfaqësuar me letra me vlerë dhe derdhja e Kapitalit themeltar të Shoqërisë të bëhet para Paraqitjes së kërkesës për Rregjistrim Person Juridik.

NENI 12

Me vendim me shkrim të Asamblesë së Ortakëve, në dispozicion të Shoqërisë mund të vihen dhe FONDE të tjera, dhe si burime akumulimi në Kapitalin fillestar, duke konsideruar si të tilla dhe DIHURIMET financiare ose materiale, të dhëna pa kushte dhe të cilat do të përdoren për nevojat e punës të Shoqërisë.

NENI 13


Shoqëria e cëllohet Llogari BANKARE në lekë vendi dhe VALUTE, si brenda dhe jashtë vendit, me qëllim për të kryer veprimet e nevojshme financiare në ushtrimin e veprimtarisë së saj, si në drejtim të Likuidimit dhe pagesave, të taksave dhe detyrimeve të ndryshme fiskale, doganore, tatimore, atyre kontraktore etj si dhe për krijimin e Fondit AKUMULIMIT, atij të VECANTE etj nga të ardhurat e veprimtarisë.

NENI 14

Ortakët, duke qenë dhe Administrator të Shoqërisë bëjnë depozitimin e nënshkrimeve origjinale të tyre, pranë Bankës apo Bankave (vendase ose të huaja) në të cilën celen llogarit dhe për rastet e transferimit të KAPITALIT Themeltar pjesëve të tij, jashtë shtetit, veprimi do të bëhet nga të dy Ortakët dhe i vertetuar me Akt Noterial.

NENI 15

LEVIZJET e Kapitalit themelor dhe atij të Akumuluar mbi bazën e Aktivit (DIVIDENTI) janë lirish të transferueshme, si për ushtrimin e çdo aktivitetit të



Shoqërise dhe për çdo rast nevojë shpenzimi vetjak JO ABUZIV, dhe vetëm mbi bazën e VENDIMIT me shkrim të përpiluar dhe nënshkruar nga ORTAKET dhe kur janë të vertetuara nga një NOTER, në të kundërtën çdo disponim jashtë këtij rregulli, është i pavlefshëm dhe nuk mund të krijojë, shuajë apo ndryshojë pasoja juridike.

NENI 16

Pjesët e Kapitalit themeltar janë lirish të TRANSFERUESHME tek të tretët, mbi bazën e Vendimit të Asamblesë së Ortakeve.

Gjithashtu ato janë lirish të transferueshme dhe në rast ndarje pasurore, në mes bashkeshortëve si dhe rrugë TRASHËGIMIE.

Për rastet e transferimit të pjesëve të Kapitalit themeltar të cilat në çdo rast vertetohen me AKT NOTERIAL, Shoqëria dhe të tretë duhet që të respektojnë këto TRANSFERIME, sapo ato tu behen të ditura.

NENI 17

Shoqëria është PRONARE dhe disponuese e të gjitha PASURIVE (të luajtshme dhe të paluajtshme) të vena në EMRIN e saj në përputhje me qëllimin dhe objektin e veprimtarisë që ajo ndjek.

NENI 18

MBROJTJA juridike civile e kësaj Pasurie dhe e veprimtarisë së Shoqërisë, si rregull GARANTOHET nga legjislati shqiptar dhe për konflikte civile, administrative etj, që mund të lindin me subjekte vendase kjo mbrojtje realizohet me anë PADISE në Gjykatën shqiptare kompetente të juridiksionit lëndor dhe tokësor, kurse për ato që lindin me Persona Juridik të huaj, Padia të behet para Gjykatës Nderkombëtare PARIS të Francës.

KREU III

DREJTIMI I SHOQËRISË, TË DREJTAT DHE DËTYRAT E ORTAKËVE

NENI 19

ORGANET DREJTUESE të Shoqërisë janë:

1. ASAMBLEA E ORTAKËVE.
2. ADMINISTRATORI.
3. BORDI I ADMINISTRIMIT.

NENI 20

ORTAKET, përfaqësojnë ose marrin pjesë me të drejtë vote të barabartë ASAMBLEN e Ortakeve, në përputhje me kontributin e vënë për krijimin e njeteve themelore të Shoqërisë.

ORTAKET Z. BASHKIM HOXHA dhe Z. GEZIM DOMI, janë njëkohësisht dhe ADMINISTRATORET e Shoqërisë.

NENI 21

Si rregull dhe përgjithësisht PERFAQËSIMI i Shoqërisë i përket ASAMBLESE së ORTAKËVE, ndërsa në mardhëniet me jashtë shteti ajo mund të përfaqësohet nga secili Ortak, të cilët kanë dhe cilësinë e Administratorit, ndërsa për rastet kur ADMINISTRATORI është i caktuar jashtë bashkësisë së Ortakeve, ai mund ta gëzojë një Tager të tillë, vetëm kur është i paisur me PROKURE.....

VENDIMET e marra nga Asamblea e Ortakeve, jane te detyrueshme
si per Ortaket dhe per Administratorin e caktuar prej tyre.

NENI 22

A. TE DREJTAT E ORTAKEVE TE SHOQERISE

ORTAKET marrin pjese ne drejtimin dhe organizimin e gjithanshem te veprimtaris e Shoqerise, ne perputhje me Legjislacionin, Aktin e Themelimit, Statutin e Shoqerise e Konventat Nderkombetare.

NENI 23

* Te kerkojne e tu jepen te gjitha informatat qe kane te bejne me ecurin e ushtrimit te veprimtarise dhe gjendjen ekonomike e financiare te Shoqerise, si dhe te gjitha dokumentat e perpunuara nga Shoqeria, ato qe kane te bejne me BILANCET, si dhe rezultatet e kontrollit financiar etj.

NENI 24

* Ortaket si vecas dhe se bashku realizojne dhe keto te drejta

Kryejne te gjitha aktet dhe veprimet juridike, qe konsiderohen se jane te vlefshme dhe te nevojshme per ushtrimin e veprimtarise dhe arrijten e qellimeve te saj, dhe konkretisht:

a. Lidhin Kontrata te ndryshme te cilat kane per Objekt dhe blerjen apo shkembimin e pasurive me Shoqeri te tjera tregetare vendase apo te huaja, me personat fizik etj.

b. Te kryejne cdo lloj veprimi ligjor prane te gjitha zyrave private apo shtetore, qe kane te bejne me garancite, sipermarrjet Siguracionet, transportin, Hipotekat, Ankandet, KREDIT, rregjistrimin e pasurive te paluajtshme objekt shitblerje, ose te marra me QERA, te kryejne me rregullsi e saktesi veprimet prane institucioneve bankare, financiare, tatimore doganore, te jene perfaqesues para Gjykatave te te gjitha shkalleve per cdo rast konflikti civil te mundshem , te hyjne ne bisedime dhe pergatisin kushtet per lidhjen e KONTRATAVE, aktmarrveshjeve me persona fizik e juridik, vendas apo te huaj, te ushtrojne te drejta te tjera reale sikurse jane HIPOTEKA (nenet 560-561 te K. Civil), UZUFUKTI (nenet 232, 235 K. Civil) SERVIFUKTI (nenet 261, 262 KODIT Civil) etj.

NENI 25

Te marrin pjese ne rezultatet e veprimtarise se Shoqerise ne cdo forme e sasi qofte.

Te heqin dore nga SHOQERIA duke ua afruar KUOTEN e tyre dhe me aprovimin e Ortakeve te tjere mund t'ua CEDOJNE(kalojne) ate te treteve. ne rast se Ortaket nuk ushtrojne te drejten e OPSIONIT. . . .

NENI 26

Mbledhja e Asamblese te Ortakeve, eshte organi me i larte VENDIMOR dhe vendimet e saj merren pas konsultimit me shkrim te ortakeve.

Per Mbledhjen e Asamblese, Ortaket duhet te njoftohen jo me pak se 15 dite para zhvillimit te saj , duke u bere i njohur Rendi i Dites dhe vene ne dispozicion paraprak gjith material dokumentar. Njoftimi per Mbledhje behet nga Kryetari Bordit te Administrimit, me rrugen postare te letres rekomande.

NENI 27

ASAMBLEA e Ortakeve, analizon te gjithë veprimtarinë e Shoqërisë, përcakton drejtimit kryesorë të ecurisë së metejshme të saj, vendos për Bilancin vjetor, për ndryshimet në STATUT dhe në AKTIN e THEMELIMIT, për shtimin ose zvogëlimin e KAPITALIT, për pranimin në shoqëri të ortakeve të tjera, vendas ose të huaj, për bashkimin me Shoqëri të tjera, Persona Juridik vendas apo të huaj për ndarjen e DIVIDENTIT (fitimit) në fund të vitit financiar, për emerimin e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, për nxjerrjen e rezultatit ekonomik financiar dhe BILANCIT vjetor, për shpërblimin e Kryetarit dhe anëtarëve të Bordit të Administrimit të Shoqërisë kur ata marrin pjesë në mbledhje, për caktimin e një apo disa Administratoreve, jashtë bashkësisë së Shoqërisë, vendos shkarkimin e anëtarëve të Bordit të Administrimit, miraton planin biznesor si dhe çdo investim etj.

NENI 28

B. ADMINISTRATORI I SHOQËRISË.

Si organ Administrativ dhe Ekzekutiv i Asamblesë së ORTAKEVE janë ADMINISTRATORET e caktuar në nenin 20 të këtij Statuti. Ata gjatë periudhës kur nuk është mbledhur Asambleja e Ortakeve, për të garantuar vazhdimësinë e rregullt të veprimtarisë së shoqërisë, PERFAQESOJNË dhe mbrojnë të drejtat e Shoqërisë brenda çaqëve dhe kompetencave që i ka dhënë Asambleja e Ortakeve.

NENI 29

ADMINISTRATORI autorizohet të veprë me këto kompetenca:

1. Të marrë vendime për çdo aspekt të veprimtarisë së rregullt dhe sipas qëllimeve të Shoqërisë, konform ligjit, Aktit të Themelimit dhe Statutit të Shoqërisë si dhe të paraqes ato për shqyrtim në mbledhjen më të afërt të Asamblesë së Ortakeve.

2. Ai ushtron të gjitha kompetencat për të vepruar në mardhëniet me të tretet në emër të Shoqërisë në çdo rrethancë, me PERJASHTIM të kompetencave që LIGJI iu a një vetëm ORTAKEVE.

3. Ka inisiativën për të kërkuar thirrjen e Asamblesë së Ortakeve për çështje që e gjykon se janë të rëndësishme dhe që kërkojnë zgjidhje të shpejta vendimore nga ana e Asamblesë së Ortakeve, të ndjekë ecurinë e planit ekonomik dhe bilancin financiar si dhe të përcaktojë emertesen e punës për çdo muaj.

4. Përcakton programin e punës dhe gezon autoritetin e punëdhënësit për të gjithë të punësuarit në Shoqëri, duke lidhur kontratat individuale me çdo të punësuar, bazuar në Kodin e Punës dhe Ligjin Mbi Sigurimet Shoqërore.

5. Ka të drejtë të verë në përdorim fonde të vecanta, të nxjerrë bilancin e fitimit për çdo muaj, të lidhë kontrata me persona juridikë e fizikë etj.

6. Administratori i caktuar jashtë bashkësisë së Ortakeve mbi bazën e Prokuresë, së dhënë nga Ortaket, mund të realizojë dhe kompetencat e tjera, brenda kufijve dhe kohës së veprimit të tagrave ligjore të njohur në PROKURË.

7. Për realizimin e kompetencave të tij dhe vazhdimësinë e veprimtarisë së Shoqërisë, Administratori informon dhe jep llogari përpara Asamblesë së Ortakeve.

8. Per veprime te kryera nga Administratori, ne mardheniet me te tretet, qe kalojne kompetencat e njohura ne kete Statut, ose PROKURE dhe qe nuk jane objekt i veprimtarise se Shoqerise dhe kur provon se te tretet ishin ne dijeni te ketyre rrethanave, Shoqeria nuk merr persiper detyrimin civil per pasojat e shkaktuara.

9. Per te gjitha veprimet e kryera nga ADMINISTRATORI i shoqerise brenda lagreve te caktuara ne Vendimin perkates te Asamblese se Ortakeve, ai eshte i detyruar qe te njoftoj menjehere dhe te jap llogari para Ortakeve te Shoqerise.

10. Administratori dhe asnje nga Ortaket nuk mund te marrin ne pune ne Shoqeri, persona, mbi bazen e iniciatives apo deshires personale te tyre, por vetem pasi te jete marre Vendim unanim nga ASAMBLEA e Ortakeve dhe te jete marre ne konsiderate dhe mendimi keshillimor i Bordit te Administrimit.

Kontratat e Punes te redaktohen dhe legalizohet nga nje NOTER.

NENI 30

Perfaqesimi Shoqerise si rregull dhe pergjithesisht i perket Asamblese se Ortakeve, kurse ne mardheniet me jashte shtetit ajo do te perfaqesohet dhe nga ADMINISTRATORET, dhe sipas rastit vecas ose duke qene sebashku.

C. BORDI I ADMINISTRIMIT

NENI 31

BORDI i Administrimit eshte organ keshillimor i Ortakeve te Shoqerise ne drejtim te dhenies se konsulences financiare, biznesit e ate juridike, ne fushen e brendeshme dhe te jashteme te Shoqerise dhe jo te atyre ne fushen e PROGRAMIMIT.

NENI 32

BORDI i Administrimit nuk ka te drejte VENDIMORE detyruese pasi ajo eshte nje e drejte eksluzive vetem e Asambles se Ortakeve. Ai perbehet nga jo me pak se 5 Persona, te cilet jane specialiste te kualifikuar ne fushen e administrimit, finances, biznesit dhe ate juridike.

NENI 33

ANETARET e Bordit te Administrimit, zgjidhen me vendim te Asamblese se Ortakeve per nje kohe 4 vjecare dhe 3 prej anetareve te saj duhet te jene te brendshem. Per cdo anetare te BORDIT te Administrimit, paraqitet dhe ruhet ne dokumentat e Shoqerise "Curriculum Vitae"

NENI 34

ORTAKET e Shoqerise duhet te marrin patjeter PELQIMIN paraprak te Bordit te Administrimit per keto probleme kryesore:

1. Per Kontratat e punesimit.
2. Per blerjen, shitjen, marrjen ose dhenien me qera, lenien peng, dorezani apo garanci hipotekore ose dhenie hua te pasurise.
3. Marrjen dhe shlyerjen e kredive bankare.
4. Perfundimin e kontratave per investime te reja, per leverdishmerin e bizneseve etj.

NENI 35

Bordi i Administrimit zhvillon mbledhjen e tij te zakonshme jo me pak se nje here ne MUAJ dhe ne mbledhjen e tij te pare percakton afatin e pergatitjes se projektrregullores dhe te miratimit te saj nga Asamblea e Ortakeve.

Me shumice votash dhe jo me me pak se paraqitjen e dy kandidatave, Bordi i Administrimit, me shumice votash zgjedh Kryetarin e tij.

NENI 36

BORDI i Administrimit shperblehet per cdo mbledhje qe ben.
Masa e shperblimit, caktohet me vendim te Ortakeve.

NENI 37

ANETARET dhe kryetari i Bordit te Administrimit me propozimin e cdo Ortaku dhe vendim konsensual te tyre mund te largohen nga detyra para afatit ligjor ne keto raste:

a. Shkelin detyrimet qe cakton Ligji per Radiotelevizionin Publik e privat dhe rregulloren e miratuar nga Bordi.

b. Verehet se jane te paafte per kryerjen e detyres.

c. mungojne pa arsye per kater mbledhje radhazi.

d. denohet nga gjykata me vendim te formes prere per kryerjen e nje vepre penale.

KREU IV :

BILANCI DHE TE ARDHURAT

NENI 38

Bilanci financiar mbyllet me 31 dhjetor te cdo viti. Llogarite vjetore, raportet mbi operacionet e vitit financiar dhe ato te hartuara nga Eksperti kontabel i autorizuar miratohen nga Asamblea e Ortakeve.

Nxjerrja e rezultateve te bilancit vjetor, duhet bere me saktesi dhe bazuar ne respektimin e te gjitha rregullave qe kane te bejne me mbajtjen e kontabilitetit nga subjektet private, te caktuara nga organet kompetente te sistemit fiskal.

Miratimi i dokumentave mbi veprimtarin vjetore behet brenda nje afati prej 6 muajsh nga data e mbylljes se vitit financiar.

Pas miratimit te Bilancit kontabel, Asamblea e Ortakeve, vendos per krijimin e fondeve ligjore, sipas nevojave te zhvillimit te metejshem te Shoqerise dhe garantimin e metejshem te veprimtarise se rregullt tregetare te saj, sikurse jane fondi i akumulimit, ai i vecante etj.

NENI 39

Te ardhurat neto pas vecimit te fondeve ligjore, iu mbesin dhe u ndahen sipas kontributit sejcilit ortak.

NENI 40

Shperndarja e Shoqerise mund te behet ne cdo kohe dhe per cfaredo shkak, sic mund te jete humbja e kapitalit, pamundesia e

vazhdimi te metejshem te veprimtarise.

Ne kete rast Asambleja e Ortakeve vendos per menyren e likuidimit dhe cakton nje ose me shume likuidatore, te cilet tregojne kujdesin e duhur dhe ne kohe per shlyerjen e detyrimeve qe ka shoqeria ndaj personave te trete fizike apo juridike.

NENI 41

Likuidatori Perfaqeson Shoqerine dhe ka te gjitha kompetencat e nevojshme per likuidimin e Aktivitetit dhe pasivit te Shoqerise.

Likuidatori i caktuar eshte i autorizuar te paguaj te gjitha kreditorët dhe tu shperndaj ortakeve, sipas kontribulit te tyre tepricen e mbetur.

KREU V :

DISPOZITAT E FUNDIT

NENI 42

Te gjitha mosmarrveshjet qe mund te lindin midis ortakeve si rregull ato duhet te zgjidhen ne mirekuptim mes tyre, ne rast te kundert ato do te zgjidhen nga Gjykata.

NENI 43


Per sa nuk eshte shprehur ne kete Statut e ne Aktin e Themelimit, duhet te behet referim ne dispozitat ligjore ne fuqi dhe ne vendimet e Asamblese se Ortakeve.

NENI 44

Ky statut eshte hartuar me printim ne 4 ekzemplare me vlera juridike te barabarta.

ORTAKET E SHOQERISE "RTV TEUTA"

1. Z. Bashkim HOXHA



2. Z. Gezim DOMI

